

Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

03/2025

DËNIMET ME GJOBË – “LEJE” PËR ARMËMBAJTJE

*Analizë e trajtimit të rasteve
gjyqësore të veprave penale të
armëve*



Shkurt, 2025

Autor: Zamira Krasniqi

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Gzim Shala.

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Shkurt 2025
Prishtinë, Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA

Lista e Shkurtesave	5
Përmbledhje ekzekutive.....	6
Metodologjia.....	8
1. Kuadri ligjor	9
2. Kompetencat për gjykimin e rasteve të armëmbajtjes pa leje	10
4. Cilësimi i veprave penale të armëmbajtjes pa leje	12
5. Politika Ndëshkimore për Veprat Penale të Armëmbajtjes pa Leje	12
6. Aplikimi i rrethanave lehtësuese dhe rrethanat rënduese	14
7. Recidivizmi si rrethanë rënduese.....	15
8. Mosrespektimi i Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikën Ndëshkimore.....	16
8.1 Qëllimet e dënimit	17
8.2 Rrethanat lehtësuese dhe rënduese	17
8.3 Dyfishimi i rrethanave	17
9. Konfiskimi i armëve	18
10. Analiza e aktgjykimeve të Apelit për rastet e armëmbajtjes pa leje gjatë periudhës 2022-2024.....	18

Lista e Shkurtesave

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

Gj.Th – Gjykata Themelore

Gj.A – Gjykata e Apelit

KPRK – Kodi Penal i Republikës së Kosovës

KPPRK – Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Armëmbajtja pa leje – Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve.

Përdorimi i armës - Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm

Përmbledhje ekzekutive

Sipas një hulumtimi të realizuar nga organizata ndërkombëtare Small Arms Survey në vitin 2018, rreth 436,000 armë gjenden në duart e civilëve në Kosovë, prej të cilave afro 392,794 janë të paligjshme. Hulumtimi tregon se çdo vit futet në Kosovë një numër prej rreth 1,200 deri në 1,300 armë të reja. Ky fakt tregon se qarkullimi i armëve pa leje është një dukuri shqetësuese në Kosovë.

Sikurse çdo forme tjetër, pritjet janë që edhe kësaj forme të kriminalitetit t'i jap përgjigje politika ndëshkimore. Përkatësisht, dënimet e shqiptuara në këto raste do duhej të parandalonin qytetarët që të mbanin armë pa leje.

Sipas Kodit Penal, vepra penale e armëmbajtjes pa leje dënohet me gjobë deri në 7.500 euro apo me burgim deri në 5 vjet. Përkundër kësaj dënueshmërie, IKD ka gjetur se politika ndëshkimore për veprat e armëmbajtjes pa leje ka qenë kryesisht e orientuar nga dënimet me gjobë derisa vetëm në raste përjashtuese janë shqiptuar dënime me burgim efektiv. Nga analiza e bërë për qëllime të draftimit të këtij raporti rezultoi se në 147 raste të armëmbajtjes pa leje janë shqiptuar 128 dënime me gjobë, 18 dënime me kusht ndërsa vetëm në një (1) rast është shqiptuar dënim me burgim. Në përqindje i bie se në vetëm 0.68% të rasteve është shqiptuar dënimi me burgim në rastet e armëmbajtjes pa leje.

Madje, edhe gjobat shqiptuara në këto raste mbeten të ulëta. IKD gjenë se mesatarja e lartësisë së gjobës për vitin 2022 ishte 623 euro, në vitin 2023 601 euro, ndërsa në vitin 2024 857 euro. Këto gjoba të ulëta, duket se janë arsyeja kryesore pse dukuria e armëmbajtjes pa leje vazhdon të jetë shqetësuese në Kosovë. Përkundër se legjislacioni në fuqi parasheh edhe mundësinë e shqiptimit të dënimit me burgim deri në pesë (5) vite, praktika e ndërtuar tanimë duket se e ka përjashtuar këtë mundësi. Kjo pasi, me një përjashtim, të gjitha dënimet e shqiptuara janë me gjobë. Kështu, figurativisht, këto gjoba tani po shërbejnë si “leje” për posedimin e kundërligjshëm të armëve. Këtë situatë e ka sjellë mungesa e një politike ndëshkimore adekuate dhe mos respektimi i Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore.

Trajtimi i rasteve të recidivizmit tregon një injorim të qëllimit të dënimit nga ana e gjykatave. Me rastin e shqiptimit të dënimit, përpos parandalimit të shoqërisë, supozohet se dënimi i shqiptuar do të parandalojë kryesin që në të ardhmen mos të përfshihet në vepra penale. Kështu, në rastet kur i njëjti përsëritë veprën penale, supozohet se dënimi duhet të jetë më i lartë, për faktin se është konstatuar se dënimi i parë nuk ka arritur qëllimin e vet. Kjo nuk ka ndodhur kështu në praktikë. Në aktgjykimet e analizuar për qëllime të këtij raporti, IKD ka evidentuar 5 raste ku personat e akuzuar për armëmbajtje pa leje kanë qenë të dënuar edhe më parë për vepra tjera penale por se të njëjtit vazhdimisht janë dënuar vetëm me gjobë. Këtu bënë pjesë edhe një rast ku i pandehuri ishte dy (2) herë i dënuar dhe dënimi i shqiptuar ishte përsëri me gjobë.

Sa i përket politikës ndëshkimore, IKD gjenë se edhe Gjykata e Apelit nuk ka pasur interesim që të ndryshohet “tradita” e Gjykatave Themelore për shqiptimin e dënimeve me gjobë në rastet

e armëmbajtjes pa leje, duke e pranuar si praktikë adekuate shqiptimin e vetëm dënimit me gjobë në këto raste.

Në këtë raport, IKD ka gjetur po ashtu cilësim jo adekuat të veprave penale të armëve. Armëmbajtja pa leje dhe përdorimi i armës janë dy vepra të ndara dhe nuk e absorbojnë njëra tjetrën. Kështu është edhe praktika e përgjithshme. Megjithatë, IKD ka identifikuar raste ku Prokuroria ka ngritur akuzë vetëm për njërin nga këto vepra, duke krijuar një amnisti për veprën tjetër. Kjo situatë ka krijuar një moskonsistencë në zbatimin e ligjit, ku në disa raste individët janë dënuar vetëm për përdorimin e armës dhe jo për mbajtjen e saj pa leje, ose anasjelltas.

IKD ka evidentuar probleme edhe në lidhje me konfiskimin e armëve. Në katër (4) raste, IKD ka gjetur se Gjykatat përkundër se kanë dënuar të pandehurit për armëmbajtje pa leje, nuk kanë konfiskuar armën. Duke vepruar në këtë mënyrë, në këto raste, Gjykata nuk ka zbatuar obligimin sipas nenit 366.3 të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, nuk ka larguar nga përdorimi armët pa leje, duke lënë pa konfiskuar një mjet të rrezikshëm.

Metodologjia

Objektivi i këtij raporti është hulumtimi në lidhje me trajtimin e rasteve gjyqësore të armëmbajtjes pa leje dhe përdorimit të armës.

Për qëllime të draftimit të këtij raporti, IKD ka analizuar gjithsej 150 aktgjykime të 7 Gjykatave Themelore në Republikën e Kosovës dhe 46 aktgjykime të Gjykatës së Apelit, të cilat janë zgjedhur në mënyrë rastësore nga webfaqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në 150 aktgjykime, 147 vendime kanë të bëjnë me veprën penale të armëmbajtjes pa leje derisa 47 prej tyre kanë të bëjnë me veprën penale të përdorimit të armës. Aktgjykimet e analizuara janë aktgjykime të publikuara gjatë viteve 2022-2024.

Përmes analizimit të aktgjykimeve, mbi bazën e një metodologjie të paracaktuar, IKD ka analizuar aspekte relevante të trajtimit të rasteve gjyqësore të armëmbajtjes pa leje dhe përdorimit të armës. Theks i veçantë i është kushtuar politikës ndëshkimore dhe aplikimit të Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore. Sa i përket këtij Udhëzuesi, Gjykata Supreme tanimë ka lansuar Udhëzuesin e ri të Gjykatës Supreme. Megjithatë, nisur nga fakti se aktgjykimet e analizuara i referohen periudhës kur ka qenë në fuqi Udhëzuesi paraprak, ky raport i referohet udhëzuesit paraprak të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore.

Përpos gjetjeve të nxjerra nga aktgjykimet, IKD po ashtu është shërbyer edhe me të dhëna të tjera publike dhe ka zhvilluar edhe intervista. Krejt në fund, me qëllim të gjithëpërfshirjes, para publikimit të këtij raporti, IKD e ka ndarë këtë raport për komente me të gjitha akterët relevantë.

1. Kuadri ligjor

Sipas Kodit NR. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës [neni 366], mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet. Në rastet kur kemi të bëjmë me katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, vepra penale dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet. Në kuadër të kapitullit XXIX të Kodit NR. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës bëjnë pjesë edhe veprat e tjera penale të armëve, importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve për kryerjen e veprave penale, Fshirja, heqja apo ndryshimi i kundërligjshëm i shenjave në armë të zjarrit apo në municione etj.

Përpos Kodit Penal, që kriminalizon veprat penale kundër armëve, në fuqi është edhe Ligji Nr. 05/L -022 për Armë, që rregullon kushtet për blerjen, posedimin, armëmbajtjen, ruajtjen, prodhimin, çaktivizimin, riparimin, tregtimin, importimin, transitin, shitjen, transportimin dhe shënjimin e armëve dhe municionit për personat fizik dhe juridik, brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dhe eksportimin nga Republika e Kosovës të destinuar vetëm për përdorim civil.

Duke u kthyer mbrapa në kohë, trafikimi dhe armëmbajtja pa leje ka filluar qysh në vitet e para pas luftës. Jo vetëm në Kosovë por në vendet e Ballkanit, në përgjithësi trafikimi me armë është një dukuri mjaft e zhvilluar, për shkak të luftës në ish – Jugosllavi, rënies së sistemeve komuniste e tranzicioneve të krijuara, ka lënë hapësirë që shumë armë të keqpërdoren e të bien në dorë të qytetarëve.¹

Sipas një hulumtimi të vitit 2015, numri i armëve të paligjshme në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 240,000. Fatkeqësisht, nuk ka të dhëna më të reja që do të mundësonin një krahasim më të saktë mbi situatën aktuale. Megjithatë, sipas një studimi të kryer nga organizata ndërkombëtare Small Arms Survey në vitin 2018, rreth 436,000 armë ndodhen në duart e civilëve, nga të cilat afërsisht 392,794 janë të paligjshme. Sipas të dhënave, çdo vit hyjnë rreth 1,200 deri në 1,300 armë, dhe kjo tendencë ka mbetur e njëjtë gjatë dekadës së fundit.²

Sipas informatave të siguruar nga MPB-ja, gjatë vitit 2022 janë raportuar 1496 raste, gjatë vitit 2023 janë raportuar 1456, ndërsa deri në shtator të vitit 2024 janë raportuar 1289 raste të armëmbajtjes pa leje.³ Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), gjatë vitit 2022 nuk është realizuar asnjë proces i shkatërrimit të armëve, ndërsa në vitin 2023 janë shkatërruar 1,572 armë zjarri. Në vitin 2024, deri në muajin shtator, janë shkatërruar 993 armë, ndërsa në muajin maj janë asgjësuar 38,310 copë municione të kalibrave të ndryshëm. Sa i përket sekuestrimeve, gjatë vitit 2022 janë sekuestruar 1,437 armë, në vitin 2023 ky numër ishte 1,392, ndërsa deri në shtator të vitit 2024 janë sekuestruar 963 armë zjarri.⁴

¹ [Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimi i Organizuar dhe Krimet e Rënda](#) (Prishtinë) 2022, f.57.

² Përgjigje nga Ministria e Punëve të Brendshme, Republika e Kosovës.

³ Përgjigje nga Ministria e Punëve të Brendshme, Republika e Kosovës.

⁴ [Kontrolli i Armëve të Vogla, të Lehta në Kosovë: Progresi dhe Sfidat](#) (2012), f.14.

Një aspekt tjetër që e bën ende më të rrezikshëm këtë fenomen është edhe përdorimi i armëve gjatë ahengjeve familjare, ku Policia e Kosovës ka raportuar se vetëm gjatë muajit gusht të vitit 2024 ka pranuar 74 raportime nga qytetarët për përdorim të armëve në ahengje.⁵ Për këtë, në tetor 2022 MPB me mbështetjen e UNDP në Kosovë lansoi fushatën vetëdijësuese “Festo me zemër e jo me armë”.⁶

Sipas statistikave policore, në Kosovë gjatë viteve 2019-2021, janë regjistruar 51 raste të veprës penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”, ndërsa për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” janë raportuar 3856 raste.⁷ Numri i armëve ilegale që janë në përdorim nga qytetarët e Kosovës vazhdon të jetë i larët, ashtu që çdo vit konfiskohen rreth 1300-1400 armë.⁸

Lidhur me identifikimin e kontrollin të armëve ilegale, në vitin 2018 The South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse for the Control of Small Arms and Light Weapons (SEESAC) kishte hartuar Udhërrëfyesi për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta (AVLE) dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor. Qëllimi i këtij Udhërrëfyesi është ofrimi një kornize për identifikimin, parandalimin, kontrollin, keqpërdorimin dhe trafikimin e paligjshëm të armëve të vogla, municioneve dhe eksplozivë.⁹ Po ashtu ky udhërrëfyesi, paraqet një mjet për matjen e progresit dhe objektivat përmes të cilave do të mund të ofrohej një mbështetje më e mirë dhe më koordinuar për AVLE-të, ku plani i udhërrëfyesit do të vihej në zbatim përmes planeve të veprimit të cilat do të jenë në përputhje me strategjitë kombëtare ekzistuese.

Sipas MPB, Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivë 2024 – 2028 është e harmonizuar me Udhërrëfyesin Rajonal (Ballkani Perëndimor) 2019 – 2024 për AVLE, dhe ka objektiva dhe aktivitete shumë të përshtatshme kundër luftës për keqpërdorimin e AVLE-ve në përgjithësi, e në veçanti trafikimit, ndërëgjegjësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.¹⁰

2.Kompetencat për gjykimin e rasteve të armëmbajtjes pa leje

Përmes Ligjit NR. 06/L – 054 për Gjykatat janë themeluar departamentet përkatëse, kështu duke krijuar një strukturë organizative të kompetencave të secilit departament në gjykatë, çka lë të kuptohet se një lëndë e caktuar nuk mund të jetë në kompetencën e dy departamenteve.

⁵ “70 persona u arrestuan gjatë gushtit për të shtëna me armë në ahengje”. IndeksOnline. 16 shtator 2024. (Shih linkun: <https://indeksonline.net/70-persona-u-arrestuan-gjate-gushtit-per-te-shtena-me-arme-ne-ahengje/>)

⁶ MPB lansoi fushatën “Festo me zemër e jo me armë”. Prishtinë, Tetor 2022.

⁷ Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimi i Organizuar dhe Krimet e Rënda (Prishtinë) 2022, f.57.

⁸ Po aty, f.60.

⁹ “UDHËRRËFYES PËR NJË ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME PËR ZOTËRIMIN E PALIGJSHËM, KEQPËRDORIMIN DHE TRAFIKIMIN E ARMËVE TË VOGLA DHE TË LEHTA (AVL) DHE MUNICIONEVE TË TYRE NË BALLKANIN PERËNDIMOR, BRENDA VITIT 2024”. https://www.seesac.org/f/docs/publications-salw-control-roadmap/Roadmap_brosura_20x20_ALB_web.pdf

¹⁰ Përgjigje nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.

Sipas Kodit NR. 04/L-123 të Procedurës Penale të vitit 2012, vepra penale e armëmbajtjes pa leje ka qenë e përfshirë në veprat penale që konsiderohen krime të rënda.¹¹ Ashtu që, deri në hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale, armëmbajtja pa leje është gjykuar në Departament të Krimeve të Rënda në Gjykatat Themelore.

Me hyrjen në fuqi të Kodit NR. 08/L-032 të Procedurës Penale në vitin 2023, kompetenca e departamenteve të gjykatave për të gjykuar rastet e armëmbajtjes pa leje ka ndryshuar, ashtu që sipas këtij Kodi, këto vepra gjykohen nga departamentet e përgjithshme.¹²

Ndryshimet ligjore nuk janë reflektuar lehtësisht në praktikë. Në disa raste, vepra penale e armëmbajtjes pa leje është shqyrtuar njëkohësisht në dy departamente të Gjykatës Themelore. Nga analiza e aktgjykimeve të gjykatave themelore për vitet 2022–2024, rezulton se deri në vitin 2022, rastet e armëmbajtjes pa leje janë gjykuar në Departamentin për Krime të Rënda. Me hyrjen në fuqi të Kodit të Procedurës Penale, ato kaluan në Departamentin e Përgjithshëm – Penal. Megjithatë, gjatë vitit 2022, është vërejtur se disa gjykata ende i kanë trajtuar këto raste në të dy departamentet, duke reflektuar mungesë qartësie në ndarjen e kompetencave.

Në vitin 2023, situata është përmirësuar, pasi shumica e rasteve janë shqyrtuar në Departamentin e Përgjithshëm – Penal, me përjashtim të një rasti të trajtuar nga Departamenti për Krime të Rënda në Gjykatën Themelore të Pejës.¹³ Po e njëjta qasje ka vazhduar edhe në vitin 2024, ku deri në shtator, rastet janë gjykuar në Departamentin e Përgjithshëm – Penal.

Një përjashtim nga ky rregull ka bërë Gjykata Themelore në Gjilan, e cila pavarësisht ndryshimeve ligjore, ka vazhduar të trajtojë rastet e armëmbajtjes pa leje në Departamentin për Krime të Rënda.

Sipas Kodit NR. 08/L-032 i Procedurës Penale, vepra e armëmbajtjes pa leje duhet të trajtohet në Departamentin e Përgjithshëm Penal të Gjykatës Themelore. Megjithatë, Gjykata Themelore në Gjilan ka vazhduar ta gjykojë këtë vepër në Departamentin për Krime të Rënda (DKR), ndonëse që nga viti 2023 kjo nuk përfshihet më në kategorinë e Krimeve të Rënda.

Nga analiza e 22 aktgjykimeve për periudhën 2022-2024, në Gjykatën e Gjilanit, IKD ka gjetur se kjo Gjykatë është e vetmja ndër 7 Gjykatat Themelore që vazhdon këtë praktikë, pavarësisht detyrimit ligjor për t'i trajtuar këto raste në Departamentin e Përgjithshëm Penal. Kjo mospërputhje bie ndesh me Kodit e ri të Procedurës Penale, që është në fuqi që nga viti 2023, dhe Ligjin për Gjykatat, në fuqi që nga 2019.

Ky mosrespektim i juridiksionit bënë që aktgjykimet të jenë nxjerrur pa respektuar kompetencën lëndore. Për këtë çështje, IKD ka kërkuar disa herë sqarim nga Gjykata Themelore e Gjilanit, të cilët kanë dhënë përgjigje jashtë kontekstit të çështjes për të cilën janë pyetur.

¹¹ Kodi nr.04/L-123 I Procedurës Penale, neni 22.

¹² Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, neni 21.

¹³ Aktgjykimi PKR.nr.24/23.

4.Cilësimi i veprave penale të armëmbajtjes pa leje

Analizimi i aktgjykimeve për qëllime të këtij raporti gjen probleme në cilësimin e veprave penale të armëve. Kjo në raportin në mes të veprës penale të armëmbajtjes pa leje dhe veprës penale të përdorimit të armës. Këto dy vepra penale, të sanksionuara me nenin 366 dhe 367 të Kodit NR. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës janë vepra të ndara dhe në rastet kur konsumohen të dy (2) veprat penale, nuk mund të konsiderohet se njëra prej tyre e absorbon tjetrën. Në fakt, kështu është edhe praktika gjyqësore në shumicën e rasteve të analizuara.

Megjithatë, në disa raste, kjo nuk ka ndodhur. Në gjashtë (6) raste¹⁴, IKD ka gjetur se Prokurori i Shtetit ka ngritur aktakuzë vetëm për përdorim të armës e jo edhe për armëmbajtje pa leje. Në pamundësi të tejkalimit të akuzës, Gjykata i ka dënuar të pandehurit në këto raste vetëm për përdorim të armës e jo edhe për armëmbajtje pa leje. Kjo mënyrë e veprimit nga ana e Prokurorit të Shtetit ka amnistuar gjashtë (6) të pandehur nga vepra penale e armëmbajtjes pa leje.

Por, ka ndodhur edhe e kundërta: IKD ka evidentuar tri (3)¹⁵ raste kur Prokurori i Shtetit i ka akuzuar të pandehurit vetëm për armëmbajtje pa leje, përkundër se në dispozitivin e aktakuzës theksohet përdorimi i armës. Kështu, të pandehurit janë dënuar vetëm për veprën penale të armëmbajtjes pa leje e jo edhe për përdorim të armës.

Kështu, kjo qasje e Prokurorit të Shtetit, që nuk është në linjë as me Kodin NR. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës dhe as me praktikën e përgjithshme në këto raste ka amnistuar të pandehurit nga vepra penale e armëmbajtjes pa leje, respektivisht përdorimit të armës.

5.Politika Ndëshkimore për Veprat Penale të Armëmbajtjes pa Leje

Vepra bazë e armëmbajtjes pa leje sipas Kodit NR. 06/L-074 Penal ndëshkohet me gjobë deri në 7.500 euro apo me burgim deri në pesë (5) vite. Përkundër kësaj dënueshmërie, gjatë analizimit të aktgjykimeve, IKD ka gjetur se politika ndëshkimore për veprat e armëmbajtjes pa leje ka qenë kryesisht e orientuar nga dënimet me gjobë derisa vetëm në raste përjashtuese janë shqiptuar dënime me burgim efektiv. Nga analiza e bërë për qëllime të draftimit të këtij raporti rezulton se në 147 raste të armëmbajtjes pa leje janë shqiptuar 128 dënime me gjobë, 18 dënime me kusht ndërsa vetëm në një (1) rast është shqiptuar dënim me burgim. Në përqindje i bie se në vetëm 0.68% të rasteve është shqiptuar dënim me burgim në rastet e armëmbajtjes pa leje.

¹⁴ Aktgjykimet P.nr. 127/2021, P.nr. 94/2022, P.nr.372/21, P.nr.16/22, PKR.nr. 140/2023, P.nr. 1872/18.

¹⁵ Aktgjykimet P.nr.156/23, P.nr.52/2020, PKR.nr. 128/22.

DËNIMET E SHQIPTUARA PËR ARMËMBAJTJE PA LEJE (2022-2024)			
GJYKATA THEMELORE	ME BURGIM	ME KUSHT	ME GJOBË
PRISHTINË	0	2	20
MITROVICË	0	3	18
PEJË	0	3	18
PRIZREN	0	3	19
GJAKOVË	1	2	17
FERIZAJ	0	1	20
GJILAN	0	4	16
KOSOVË	1	18	128

Tabela 1. Dënimet e shqiptuara për armëmbajtje pa leje (2022 – 2024).

Madje, analiza thekson se edhe lartësia e gjobës mbetet e ulët, në krahasim me maksimumin e saj ligjor. Nëse mesatarja e vlerës së dënimeve llogaritet duke u bazuar në mesataren e secilës prej shtatë Gjykatave Themelore për vitin përkatës, atëherë i bie që në përgjithësi mesatarja e lartësisë së gjobës për vitin 2022 ishte 623 euro, në vitin 2023 601 euro, ndërsa në vitin 2024 857 euro.


MESATARJA E VLERËS SË DËNIMEVE ME GJOBË PËR ARMËMBAJTJE PA LEJE (2022-2024)			
GJYKATA THEMELORE	2022	2023	2024
PRISHTINË	€ 664	€ 419	€ 900
MITROVICË	€ 520	€ 933	€ 1,480
PEJË	€ 533	€ 650	€ 700
PRIZREN	€ 580	€ 510	€ 914
GJAKOVË	€ 880	€ 720	€ 786
FERIZAJ	€ 807	€ 460	€ 812
GJILAN	€ 380	€ 517	€ 410
KOSOVË	€ 623	€ 601	€ 857

Tabela 2. Mesatarja e vlerës së dënimeve me gjobë për armëmbajtje pa leje (2022 – 2024).

Kështu, IKD gjen se Gjykatat injoruan sanksionimin ligjor të kësaj vepre penale, se e njëjta është e dënueshme me gjobë deri në 7500 euro apo me burgim deri në 5 vite burgim. Duke pasur parasysh se dënimet e shqiptuara janë brenda limiteve ligjore dhe se secili rast ka specifikat e saja, shqiptimi i dënimit me burgim efektiv në vetëm 0.68% të rasteve dhe gjobave relativisht të njëjta, duket se dënimet më tepër i ngjajnë tanimë një praktike jashtë ligjore dhe shabllone të krijuar nga Gjykata, se sa dënimeve ligjore në përputhje me rrethanat e rastit. Mos zbatimi i Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore, për të cilën do të flasim në vijim, e forcon këtë argument.

6. Aplikimi i rrethanave lehtësuese dhe rrethanat rënduese

Sa i përket aplikimit të rrethanave, gjetjet e IKD të dala nga analizimi i aktgjyqimeve dëshmojnë për një fokus jo proporcional të Gjykatave në rrethanat lehtësuese në raport me rrethanat rënduese. IKD ka gjetur se në 145 raste si rrethanë lehtësuese është aplikuar pranimi i fajësisë, ndërsa pendimi si rrethanë lehtësuese është aplikuar 76 herë, padënueshmëria në 75 raste etj.




Grafika 1. Rrethanat lehtësuese gjatë periudhës 2022 – 2024.

Sipas Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore, gjykatat duhet të jenë veçanërisht të vetëdijshme, ashtu që të mos bëhet vetëm një aplikim i përgjithshëm i rrethanave lehtësuese por të merret në shqyrtim situata e kryerjes së veprës penale dhe vet kryerësit ashtu që rrethanat lehtësuese të shqiptuara të jenë në proporcion me kryerësin dhe veprën penale të kryer.¹⁶ Ky standard i përcaktuar me këtë udhëzues nuk është marrë parasysh nga Gjykatat në aktgjyqimet e analizuara. Parimisht, rrethanat lehtësuese vetëm janë përmendur në aktgjyqime dhe nuk është bërë asnjë arsyetim lidhur me aplikimin e atyre rrethanave.

Ndërsa, sa i përket rrethanave rënduese gjykata në të shumtën e rasteve kanë injoruar këto rrethana. Shkalla e përgjegjësisë penale si rrethanë rënduese është aplikuar në 30 raste, ndërsa rrezikshmëria shoqërore si rrethanë ka gjetur aplikim në 34 raste.

¹⁶ [Udhëzues për Politikën Ndëshkimore i Gjykatës Supreme të Kosovës \(Prishtinë\) 2018, f.50.](#)



Grafika 2. Rrethanat Rënduese gjatë periudhës 2022 – 2024.

Megjithatë, disa nga këto rrethana, nuk cilësohen fare si rrethana rënduese sipas Kodit NR. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës. Sipas këtij Kodi¹⁷ dhe Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore¹⁸, shkalla e përgjegjësisë penale dhe intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur janë parime të dënimit dhe jo rrethana rënduese.

Edhe në këtë rast, duke marrë parasysh diskrecionin e gjyqtarëve dhe specifikat e secilit rast, fokusi jo proporcional i gjykatave në rrethanat lehtësuese, duke mos arsyetuar të njëjtat në secilin rast, në raport me rrethanat rënduese duket që tanimë paraqet një dukuri dhe jo përshtatje të dënimit. Kjo qasje duket se ka sjellë edhe politikën e butë ndëshkimore në këto raste, ku dënimet e shqiptuara parimisht janë me gjobë.

7. Recidivizmi si rrethanë rënduese

Sa i përket recidivizmit, Udhëzuesi i Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore thekson se “[k]jo rrethanë njeh bindjen e përgjithshme se individët të cilët kanë kryer vepra penale në të kaluarën duhet të dënohen më ashpër sesa ata të cilët nuk kanë kryer. Ajo gjithashtu pranon se dënimet e mëparshme kanë dështuar në rehabilitimin apo reformimin e kryerësit. Në esencë, qëllimi i dënimit fillon të shmanget nga perspektiva e rehabilitimit në drejtim të konceptit të parandalimit të veprave të kryerësit në të ardhmen”. Megjithatë, në disa raste kjo nuk u reflektua. Përkundër se qëllimi i dënimit nuk u arrit, Gjykatat vazhdojnë të shqiptojnë dënime përafërsisht të njëjtë.

Në aktgjykimet e analizuar për qëllime të këtij raporti, IKD ka evidentuar 5 raste ku personat e akuzuar për armëmbajtje pa leje, kanë qenë të dënuar edhe më parë për vepra tjera penale por se të njëjtat vazhdimisht janë dënuar vetëm me gjobë. Kjo qasje krijon bindjen se mundësia e

¹⁷ Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 69.3.

¹⁸ [Udhëzues për Politikën Ndëshkimore i Gjykatës Supreme të Kosovës \(Prishtinë\) 2018](#), f.38.

shqiptimit të dënimit me burgim në rastet e veprave penale të armëmbajtjes pa leje tanimë është e paaplikueshme.

Sipas 5 vendimeve të shqiptuara nga Gj.Th, IKD ka gjetur se në 2 raste të recidivizmit gjykata ka shqiptuar dënim me gjobë prej 1.000 euro,¹⁹ ndërsa në tri rastet tjera ka shqiptuar dënime me gjobë në vlerë prej 800 euro, 1.800 euro dhe 2.000 euro.²⁰ Përkundër dështimit të vazhdueshëm të këtyre dënimeve që ta arrijnë qëllimin e tyre, parandalimin e kryerësit që në të ardhmen mos të kryejë vepra penale, gjykata theksoj se këto dënime me gjobë për recidivist janë të mjaftueshme dhe të njëjtat mund të arrijnë në parandalimin e kryerësit të veprave tjera penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tyre e po ashtu edhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Në Gjykatën Themelore në Ferizaj, një person që më parë ishte dënuar dy herë për të njëjtën veprë penale, përsëri u dënua me një gjobë prej 1.000 eurosh. Ky dënim u konsiderua i përshtatshëm duke u bazuar në peshën e veprës, rrethanat e saj, përgjegjësinë dhe personalitetin e kryerësit. Kjo tregon se po ndiqet një model “shabllon” i politikës ndëshkimore në rastet e armëmbajtjes pa leje.

Përderisa, Gjykata me shqiptimin e dënimit të parë për veprën penale nuk e ka arritur qëllimin sa i përket parandalimit të kryerësit për përsëritje të veprës penale, dhe përsëri gjykata e dënon të njëjtin me dënim me gjobë, shihet një shpërfillje e gjykatës sa i përket vëmendjes së veçantë që duhet t’i kushtohet recidivizmit.

Këto raste dëshmojnë se politika ndëshkimore e aplikuar nga Gjykatat jo se nuk ka arritur parandalimin e shoqërisë nga kryerja e këtyre veprave penale, por nuk e ka arritur as parandalimin e të pandehurit që në të ardhmen mos të përfshihet në vepra penale. Kur përsëritja e veprës penale ka ndodhur, dënimi ka qenë përsëri me gjobë, duke përçuar mesazhin se ata mund të mbajnë armë pa leje për aq sa janë në gjendje t’i paguajnë gjobat.

8. Mosrespektimi i Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikën Ndëshkimore

Udhëzuesi i Gjykatës Supreme në mënyrë të qartë ka shtjelluar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me matjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi mënyrën se si duhet vepruar Gjykatat në secilin rast konkret. Mirëpo edhe pse kanë kaluar mbi 6 vite nga publikimi i këtij Udhëzuesi, nga hulumtimi i IKD-së rezulton se nuk ka pasur një përfshirje të këtij udhëzuesi me rastin e shqiptimit të dënimeve.

Në nëntor të vitit 2024, Gjykata Supreme e ka reviduar këtë Udhëzues duke publikuar Udhëzuesin e ri, analiza mbi zbatimin e së cilit do të publikohet në të ardhmen nga IKD.²¹

¹⁹ Aktgjykimet P.nr.934/23 dhe 2022:164076

²⁰ Aktgjykimet P.nr.4077/2019, P.nr.776/24 dhe PKR.nr.145/22

²¹[Udhëzues i Përgjithshëm për Matjen e Dënimit, Botimi II. \(Prishtinë\) Nëntor 2024.](#)

8.1 Qëllimet e dënimit

Në bazë të analizës së aktgjykimeve, IKD gjenë se Gjykatat Themelore nuk i kanë marrë për bazë në mënyrë adekuate qëllimet e dënimit të cilat janë të parapara me Udhëzues të cilat janë: 1) të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, 2) të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprës penale, 3) të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe 4) të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjetjet e IKD tregojnë se në shumicën e rasteve, gjykata vetëm i ka përmendur këto qëllime mirëpo duke mos bërë asnjë lloj shtjellimi mes qëllimeve dhe dënimit të shqiptuar.²² Shpërfillja e këtyre qëllimeve vie në shprehje sidomos te rastet e recidivizmit, siç u elaborua në kapitullin 7 të këtij raporti.

8.2 Rrethanat lehtësuese dhe rënduese

Udhëzuesi i Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore ka paraparë se mosarsyetimi i aplikimit të rrethanave por vetëm përfshirja e tyre në dënim pa ndonjë shpjegim adekuat paraqet dështim dhe mungesë të orientimit nga ana e gjykatave.²³

Analiza e aktgjykimeve vë në pah mungesën e arsytimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese nga ana e Gjykatave, të cilat rrethana konsiderohen parakusht për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Nga kjo analizë, IKD gjenë se në shumicën e rasteve, gjykatat në kundërshtim me Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore, vetëm kanë përmendur këto rrethana, por se nuk kanë bërë ndonjë ndërlidhje me parimet që duhen të merren për bazë me rastin e caktimit të dënimit nga gjykata.²⁴ Në shumicën e rasteve, gjykata nuk ka dhënë shpjegime se pse i ka marrë për bazë rrethanat e caktuara lehtësuese apo rënduese, duke mos e arsyetuar mbështetjen e tyre.

8.3 Dyfishimi i rrethanave

Udhëzuesi i Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore thekson nevojën për ndalimin e llogaritjes së dyfishtë të rrethanave. Kjo në kuptimin që elementet e veprës penale për të cilën shqiptohet dënimi mos të parashihen si rrethana lehtësuese apo dënuese, si dhe e njëjta rrethanë në këndvështrime të ndryshme, mos të aplikohet dy herë.

Në kuadër të analizimit të aktgjykimeve, IKD ka evidentuar raste kur Gjykatat kanë bërë dyfishim të rrethanave. Në aktgjykimet e analizuar është vërejtur se gjykata si rrethanë lehtësuese ka përfshirë edhe pranimin e fajësisë dhe pendimin e keqardhjen. Sipas udhëzuesit të Gjykatës Supreme, pranimi i fajësisë nënkupton keqardhjen dhe pendimin për veprën penale të kryer.²⁵ Në këtë kontekst, IKD ka gjetur se nga 150 aktgjykime në 76 raste Gj.Th ka përfshirë

²² Udhëzues për Politikën Ndëshkimore i Gjykatës Supreme të Kosovës (Prishtinë) 2018, f.33-37.

²³ Po aty, f.10 - 11.

²⁴ Shala, G. "Politika e Dënimeve në Kosovë". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, Nëntor 2019. (Shih linkun: [Politika-ndeshkimore-ALB-FINAL-2.pdf](#))

²⁵ Po aty, f.31.

si rrethanë lehtësuese edhe pranimin e fajësisë dhe pendimin. Në këtë mënyrë, në vend të një, janë llogaritur dy (2) rrethana lehtësuese.

Gjithashtu, IKD ka hasur raste kur caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit është bërë duke marrë për bazë si rrethana lehtësuese dhe rënduese shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore, motivet për kryerjen e veprës penale si dhe rrethanat në të cilën është kryer vepra si rrethana rënduese. Në fakt, këto nuk mund të konsiderohen rrethana lehtësuese apo rëndësuese, por se të njëjtat konsiderohen parime të caktimit të dënimit, që duhet ndërlidhur me rrethanat e rastit konkret.²⁶

9. Konfiskimi i armëve

Është e natyrshme se në rastet e dënimeve për armëmbajtje pa leje, gjykatat duhet të konfiskojnë armën. Për këtë, Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës [neni 366.3] ka përcaktuar se *“Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet”*.

Megjithatë, janë evidentuar raste kur kjo nuk ka ndodhur. Në katër (4) raste²⁷, IKD ka gjetur se Gjykatat përkundër se kanë dënuar të pandehurit për armëmbajtje pa leje, nuk kanë konfiskuar armën. Duke vepruar në këtë mënyrë, në këto raste, Gjykata nuk ka zbatuar obligimin sipas nenit 366.3. të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, nuk ka larguar nga përdorimi armët pa leje, duke lënë pa konfiskuar një mjet të rrezikshëm. Për këtë, gjykatat në këto aktgjykime nuk kanë dhënë asnjë arsytim.

10. Analiza e aktgjykimeve të Apelit për rastet e armëmbajtjes pa leje gjatë periudhës 2022-2024

Gjykata e Apelit si shkallë e dytë e ka mundësinë e po ashtu është përgjegjësi e saj që përmes ankesave qoftë nga prokuroria apo nga pala tjetër, të vlerësoj nëse aktgjykimi i shkallës së parë është në përputhje me dispozitat ligjore e legjislacionin në fuqi. Mirëpo, IKD ka gjetur se në rastet e trajtimit të veprës penale për armëmbajtje pa leje, edhe Gjykata e Apelit nuk ka pasur shumë ndryshim nga Gjykata Themelore. Nga kjo analizë e aktgjykimeve të Apelit, IKD ka gjetur se edhe pas përpjekjeve të prokurorisë përmes ankesave në këtë gjykatë, kundrejt aktgjykimeve të shkallës së parë, Gjykata e Apelit ka vazhduar me një lloj praktike pak a shumë identike sikurse Gjykatat Themelore, duke etabluar si rregull dënimin me gjobë në rastet e armëmbajtjes pa leje.

Nga 46 aktgjykimet të analizuara, IKD ka gjetur se përgjatë periudhës 2022 - 2024, Gjykata e Apelit ka vërtetuar 40 aktgjykime të gjykatës së shkallës së parë, ku në 11 raste, ankesë është bërë nga ana e Prokurorisë. Kuptohet, dënimi ka pasur mundësi të ndryshohet në dëm të pandehurit vetëm në rastet kur ankesë është parashtruar edhe nga ana e Prokurorit të Shtetit.

Në rastet kur prokuroria ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, ankesa janë parashtruar për shkak të llojit dhe lartësisë së dënimit. Nga këto 11 raste për të cilat ka bërë ankesë

²⁶ Po aty, f.38.

²⁷ Aktgjykimet P.nr.108/2022, P.nr.479/2023, P.nr.87/2022, 2022:172504.

Prokuroria, në 5 raste Gj.A ka refuzuar ankesën e duke vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë²⁸ ndërsa në 6 raste tjera ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë kështu duke ndryshuar vlerën e dënimit me gjobë për veprën e armëmbajtjes pa leje²⁹. Por, në asnjërën prej tyre nuk ka shqiptuar dënim me burgim efektiv.

Nga kjo analizë lehtësisht vërehet se edhe Gj.A nuk ka pasur interesim që të ndryshohet “tradita” e Gjykatave Themelore, në një mënyrë nuk ka treguar gatishmëri që të ndryshohet praktika e gjykatës së shkallës së parë lidhur me dënimet e armëmbajtjes pa leje, duke e pranuar si praktikë adekuate shqiptimin e vetëm dënimit me gjobë në rastet e armëmbajtjes pa leje.

²⁸ Aktgjykimi PAKR.nr.596/2022, PA1.nr.376/24, PA1.nr.7/24, PAKR.nr.384/2022, PA1.nr.1361/2023.

²⁹ Aktgjykimi PAKR.nr.373/2022, PAKR.nr.246/22, PAKR.nr.426/22, PAKR.nr.68/22, PAKR.nr.677/22, PA1.nr.731/2024.